



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE
Departamenti i Biologjisë

RAPORT

Lidhur me shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për pranim në programin e studimit Biologji Molekulare për vitin akademik 2026/2027, komisioni i emëruar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Ref. nr. 2360, datë 08.07.2026, në përbërje:

- Ass. Nesade Muja-Bajraktari, kryetare;
- Ass. Bledar Pulaj, anëtar;
- Ass. Alban Hyseni, anëtar;

në zbatim të detyrave të përcaktuara me vendimin e lartcekur, shqyrtoi ankesat e kandidatëve të paraqitura kundër listës preliminare të rezultateve të konkursit për pranim në programin **Biologji Molekulare**.

Komisioni, gjatë shqyrtimit të ankesave, është mbështetur në:

- Konkursin e Senatit të Universitetit të Prishtinës, Nr. Prot. 1/999, datë 29.06.2026, për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore (bachelor) për vitin akademik 2026/2027;
- Statutin e Universitetit të Prishtinës;
- Rregulloren për studimet bachelor në Universitetin e Prishtinës;
- dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët dhe dokumentacionin zyrtar të konkursit.

Komisioni shqyrtoi ankesat e paraqitura më **10.07.2026**, si më poshtë:

Nr. Nr. i dosjes Nr. i protokollit Data e ankesës

1	100028	2433	10.07.2026
2	100143	2430	10.07.2026
3	100263	2443	10.07.2026
4	100278	2405	10.07.2026

Konstatimet e Komisionit

Pas verifikimit të dokumentacionit të secilit kandidat, formularëve të aplikimit, dokumenteve të shkollimit, mënyrës së llogaritjes së pikëve dhe zbatimit të kriterëve të përcaktuara në Konkurs, Komisioni konstatoi se:

- të gjitha ankesat janë paraqitur brenda afatit të përcaktuar në Konkurs;
- për secilën ankesë është bërë verifikimi i dokumentacionit dhe i llogaritjes së pikëve sipas kriterëve të Konkursit;
- janë shqyrtuar të gjitha pretendimet e kandidatëve në raport me dokumentacionin zyrtar të administruar nga Fakulteti;
- gjatë shqyrtimit nuk janë konstatuar shkelje procedurale në zhvillimin e procesit të pranimit, pra janë plotësuar kuotat e parapara me konkurs,
- dhe vendet e paplotësuara janë të rezervuara për kategoritë e tjera (komunitetet joshumicë dhe Shqiptarët nga Presheva, Bujanoci, Medvegja, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Mali i Zi, dhe diaspora), të cilat do të rishpallen në përputhje me afatin plotësues sipas statutit të UP-së dhe rregullores së studimeve themelore.

Prishtinë, 14.07.2026

Komisioni

1. **Ass. Nesade Muja-Bajraktari** _____
Kryetare
2. **Ass. Bledar Pulaj** _____
Anëtar
3. **Ass. Alban Hyseni** _____
Anëtar

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCËVE MATEMATIKE-NATYRORE
PRISHTINË

Planuar me: 14/07/2026			
Nj. org.	Numër	Sasia	Vlera
01	2501	3	—